



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

KEC

Kodi: 031

EDUKIMI PËR TË DREJTËN SHOQËRORE

Qëllimet e programit

Me përvetësimin e këtij Programi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje:

- të thellojnë njohuritë, të kuptuarit dhe ndjeshmërinë për mekanizmat që përjetësojnë dhe mbajnë sistemet e dominimit,
- të ndërtojnë përkushtimin ndaj procesit të ndërtimit të kapacitetit për transformim personal, profesional dhe institucional.

Përmbajtja

Programi Edukimi për të drejtën shoqërore, është një program trajnimi i cili ka për qëllim krijimin e vetëdijes kritike për të njohur diversitetin kulturor, gjuhësor dhe etnik, si vlerë njerëzore. Pranimi i të tjerëve pa paragjykim, të qenit tolerant dhe i hapur, janë sjellje thelbësore të çdo qytetari, si dhe kusht për krijimin e një shoqërie demokratike. Një qasje e tillë i mundëson çdo qytetari të drejtën për të qenë i pranuar dhe i trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë, në aspektin individual, shoqëror dhe institucional.

Rezultatet për Modulin e parë – Ndërtimi i vetëdijes kritike

Pjesëmarrësit do të:

- zhvillojnë aftësitë për të menduar në mënyrë kritike për të kuptuar realitetin në formë të drejte dhe angazhimin që duhet bërë për luftimin e padrejtësive.
- njohin nivelet e ndryshme të përgjegjësisë në përjetimin e dominimit sistematik ,
- njohin strategjitë që u ndihmojnë në transformimin e ambientit të tyre personal dhe institucional.

Rezultatet për modulin e dytë – Reflektim ndaj veprimit

Pjesëmarrësit do të:

- zhvillojnë dhe thellojnë të kuptuarit për stereotipet dhe do të zhvillojnë shkathtësi për t'i zbërthyer stereotipet,
- thellojnë të kuptuarit për format e shtypjes,

- mësojnë se si t'i zbatojnë strategjitë të cilat do tu ndihmojnë në transformimin e ambientit të tyre personal dhe institucional.

Punëtoritë janë kombinim i prezantim të njohurive teorike dhe punës praktike. Aktivitetet zhvillohen në grup të madh, grupe te vogla si dhe punë individuale. Të gjitha aktivitetet janë prezantim i jetës reale të cilat i bëjnë pjesëmarrësit të mendojnë në mënyrë kritike dhe i bëjnë ata personalisht të angazhohen për reflektim personal në lidhje me padrejtësitë, shtypjen dhe sistemin e dominimit në ambientet të ndryshme private dhe institucionale.

Grupi i synuar

Ky program u dedikohet punëtorëve të arsimit, juristeve, gazetarëve, përfaqësuesve të OJQ-ve, si dhe të gjithë atyre që tregojnë interesim për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre në lidhje me relacionet njerëzore.

Forma e organizimit/ Kohëzgjatja

Programi Edukimi për të drejtën shoqërore- trajnim për të rritur, përbëhet prej dy moduleve. Programi prezantohet në formë të punëtorive dhe ka gjithsej 48 orë. Koha në mes të mbajtjes së dy seminareve duhet të jetë së paku 5 muaj. Çdo seminar ka 24 orë trajnimi.

Certifikimi

Kusht për certifikim është vijueshmëria e plotë e 90% e trajnimeve

